



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Deliverty	01.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHUK	3874/2022		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.461/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.461/2022 të datës 18.05.2022 të parashtruar nga \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “transfer”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.461/2022 e datës 18.05.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi për transferim e ankuesit me numwr:135 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB i datës 16.05.2022 .

A r s y e t i m

Ankuesi, \_\_\_\_\_ i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kundër vendimit për transferim të datës 16.05.2022 të Zv/Drejtoreshës së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se pozita në të cilën është transferuar ankuesi nuk është e barasvlershme për nga detyrat, përgjegjësit si dhe koeficienti pasi që sipas Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm

të Republikës së Kosovës pozita "Drejtor i Përgjithshëm" është evidente ndërsa mos përfshirja e kësaj pozite në Rregulloren (ZKM) Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, atakon drejtpërdrejt aktin e emërimit, gradën diplomatike dhe koeficientin e zyrtarit publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.05.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Këshilli, me datë 02.06.2022 me numër protokollit 3222/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr.461/2022 të datës 18.05.2022, me numër protokollit 12884/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 18.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.05.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 02.06.2022 me shkresat e lëndës; Vendimin për themelimin Komisionit të Ristrukturimit i datës 24.02.2022 me numër V.nr 01/KR/2022; Vendimin për miratimin e detyrave të punës i datës 16.03.2022 me numër VPD.Nr.01/2022; Lista e pozitave të cilave u është miratuar përshkrimi i detyrave të punës; E-mailin e datës 11.03.2022 dërguar nga S.K. për V.B; Njoftimin e datës 15.03.2022 të Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore; Raportin e punës dhe propozimin e Komisionit të Ristrukturimit i datës 23.03.2022; E-mailin e datës 28.04.2022 dërguar nga B.I për V.B; Raportin e punës dhe propozimin e Komisionit të Ristrukturimit i datës 06.05.2022; Vendimin për transferimin e ankuesit i datës 16.05.2022; Vendimin e datës 28.08.2008; kërkesën e ankuesit të datës 11.03.2009; Dëshmia e dokumenteve e datës 11.03.2009; Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës i datës 01.10.2009; Vendimin për emërimin e ankuesin në pozitën e Drejtorit të Akademisë Diplomatike i datës 16.10.2012; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të datës 11.10.2013; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit Nr.97/2013 i datës 23.10.2013; Vendimin për emërimin e Drejtorit të Akademisë Diplomatike i datës 27.05.2015; Vendimin për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm i datës 13.05.2016; Akt emërimin e ankuesit me numër:097 i datës 21.07.2016; Vendimin e Komisionit Disiplinor të MPJD-së i datës 26.11.2020; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Përgjithshëm; Vendimin e Këshillit me numër A.nr.216/2022; Vendimin e Këshillit A.nr.142/2022; Vendimin e Këshillit A.nr.413/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit

***është e pabazuar, sepse:***

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi në bazë të aktit të emërimit të datës 21.07.2016 me numër:097 është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, në pozitën: "Drejtor i Përgjithshëm", ndërsa përmes vendimit me numër:135/2022 të datës 16.05.2022 të Zv/Drejtoreshës së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme është transferuar në pozitën "Drejtor i Departamentit për Amerikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës" për shkak të ristrukturimit të institucionit, respektivisht Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore neni 15 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *“Ministria drejtohet nga ministri dhe organizohet në këto nivele: 1.1. sekretari i përgjithshëm; 1.2. departamentet, dhe 1.3. divizionet”*, dhe po ashtu neni 54 i të njëjtit ligj ka paraparë që: *“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji i Administratës Shtetërore nr. 03/L-189 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj”*, ndërsa sipas vendimit me numër: VPD.nr.01/2022 të datës 16.03.2022 për miratim të përshkrimit të detyrave të punës të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB me listën e bashkangjitur të pozitave që iu është aprovuar përshkrimi i detyrave të punës në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kolegji ka gjetur se ristrukturimi i brendshëm i bërë në frymën e dispozitës së lartcekur ligjore, ndërsa pozita të cilin e ka ushtruar ankuesi sipas aktit të emërimit të datës 21.07.2016 *“Drejtor i Përgjithshëm”* me rastin e ristrukturimit është shuar.

Komisioni i Ristrukturimit i cili është themeluar sipas vendimit me numër V.nr.01/KR/2022 të datës 24.02.2022 ka nxjerr propozimin që ankuesin ta emërojnë në një institucion tjetër të Shërbimit Civil pasi që pozita të cilin e ka mbajtur ankuesi nuk është përcaktuar të ekzistojë sipas Rregullores (ZKM) Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa propozimi iu është përcjellë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa me datë 28.04.2022 Zv/Drejtoresha e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i ka kthyer Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD e-mail përmes të transferimit e ankuesit e kthen në kompetencë të Komisioni i Strukturimit me arsyetimin se pozita të cilën e mban aktualisht ankuesi” Drejtor i Përgjithshëm” nuk hynë në kuadër të pozitave të nivelit të lartë drejtues, duke i kërkuar të ofrojë rekomandim për pozitën konkrete se ku do të transferohet ankuesi, ndërsa Komisioni i Ristrukturimit me datë 06.05.2022 ka nxjerr raportin me numër:681/03 përmes të cilin i njëjti është rekomanduar që të transferohet në pozitën *“Drejtor i Departamentit për Amerikë”* në kuadër MPJD në pajtueshmëri me nenin 54 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit”*, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datë 16.05.2022 në pajtim me rekomandimin e Komisionit të Ristrukturimit ka nxjerr vendim për transferimin e ankuesit, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se transferimi i ankuesit është bërë në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nenin 54 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ku përcaktohet se: *“Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar”*.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe në kuptim të nenin 10 dhe 11 lidhur me klasifikimin e pozitave në Shërbimin Civil si dhe në bazë të praktikës vendimmarrëse të Këshillit respektivisht vendimit A.nr.413/2020 dhe shkresave të bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se pozita të cilën ankuesi e ka mbajtur përpara se të transferohet me rastin e

Ristrukturimit të Institucionit ku punon nuk hynë në kategorinë e pozitive të larta drejtuese, andaj në kuptim të nenit 54 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "Nëpunësi mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3 të nenit 52 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përbën shkak për lirim nga Shërbimi Civil.", ndërlidhur me nenin 52 paragrafi 3 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: 3.1. kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 100 km nga vendbanimi i nëpunësit civil" Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara pasi që asnjëra nga parakushtet e përcaktuara nuk plotësohet e cila do t'i siguronte bazë ligjore ankuesit për ta refuzuar transferimin, ndërsa pozita të cilën ankuesi e ka mbajtur para se të transferohet me pozitën në të cilën është transferuar janë ekuivalente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.461/2022

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshtref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së

